



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Br. Prot. <u>01-4811/15</u>
Nr. I faq.	Prot. No.
Broj stranica	Data
Nr. pages <u>02</u>	Datum <u>17-12-2015</u>
	Date
	<u>17-12-2015</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 17.12.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4293/15, për zyrtarin e lartë z. Bekim Azizi, Këshilltar Komunal në Komunën e Vitisë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të mundshëm të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4293/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Bekim Azizi, Këshilltar Komunal në Komunën e Vitisë.

Gjatë procesit për identifikimin e rasteve të dyshuara për konfliktit të mundshëm të interesit, është identifikuar rasti për zyrtarin e lartë z. Bekim Azizi, Këshilltar Komunal në Komunën e Vitisë, gjatë kontrollit është vërejtur se zyrtari i lartë ka të regjistruar një biznes privatë dhe figuron si person i autorizuar në këtë biznes e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 24.11.2015, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Bekim Azizi, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, për të marr informata lidhur me shkresën e dërguar në adresën e tij, dhe për tu sqaruar me gjerësisht.

Zyrtari i lartë, z. Bekim Azizi, Këshilltar Komunal në Komunën e Vitisë, gjatë bisedës është pajtuar me gjendjen, dhe është zotuar se brenda afatit ligjor do të bëjë ndryshimet dhe do të veprojë sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Me datën 10.12.2015, kemi pranuar dokumentin zyrtar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Bekim Azizi, nuk figuron më si person i autorizuar në biznesin N.P.SH "Aftësimi" me numër biznesi 70085330.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Bekim Azizi, Këshilltar Komunal në Komunën e Vitisë duke bërë ndryshimet në biznesin privat, dhe duke hequr dorë nga ushtrimi i funksionit të personit të autorizuar në biznesin e tij, janë krijuar rrethana të reja dhe konstatohet se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Prëteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

